



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 3, datë 10/ 9 /2015

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR PËR
“PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË LINJËS SË RE TË FURNIZIMIT ME
UJË TË QYTETIT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të germës “c”, të nenit 9, të ligjit 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”; germës “ç”, të pikës 4, të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozim të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor për “Projektin e ndërtimit të linjës së re të furnizimit me ujë të Qytetit të Durrësit”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDIRAMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. serie 00001

LEJE
PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
Nr.prot. 390, datë 10 / 9 / 2015

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
Nr. 3, datë 10 / 9 / 2015

Emri i subjektit: **Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime.**

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna: **Nr. QKR (NIPT): K 52130004 U**

Baseni Ujor: **Mat, Ishëm – Erzen.**

Qarku: **Lezhë, Durrës.**

Bashkia/ Komuna: **Kurbin, Durrës.**

Koordinatat:	FM- 1:	X-390833.862	Y-4614106.771
	FM- 4:	X-390588.329	Y-4613952.688
	FM- A:	X-390960.831	Y-4613966.646
	FM- B:	X-391204.251	Y-4613824.682
	FM- D:	X-391486.021	Y-4614064.762
	FM- E:	X-391577.816	Y-4613668.259

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji : **Përdorimi i burimit ujor nëntokësor për furnizim me ujë të pijshëm të Qytetit të Durrësit.**

Prurja mesatare	0,62	m ³ /s
Prurja ekologjike	-	m ³ /s
Sasia e ujit që jepet për përdorim	0,62	m ³ /s

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) **nuk ka** m³ /s dhe vendi ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet **nuk ka**.

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura : **Impianti i pastrimit të ujërave të ndotur, Durrës.**

Sipërfaqja e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) **nuk ka** (ha).

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka) **nuk ka**.

Periudha e vlefshmërisë: **5 (pesë) vjet.**

KRYETAR

EDI RAMA



Kushtet e Lejes

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje;
2. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth;
3. Përdoruesi i ujit është i detyruar të vendosë matës ujit me shpenzimet e veta sipas rregullave që vendosin autoritetet e ujit;
4. Në rastet kur uji përdoret si produkt ushqimor, procedurat e prodhimit duhet të jenë konform rregullave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
5. Burimi ujqor të shfrytëzohet nga zotëruesi i lejes;
6. Brenda 2 muajve nga pajisja me leje, subjekti duhet të fillojë veprimtarinë për të cilën është pajisur me leje;
7. Leja ndalohet t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejtë ose si pasojë, dëmtimin e burimit ujqor;
9. Subjekti të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse;
10. Subjekti të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim lidhur me mënyrën e përdorimit të burimit ujqor;
11. Për shkeljen e kushteve të lejes, do të merren masa në përputhje me Kreun XIX të Ligjit nr.111/2012;
12. Zotëruesi i lejes paguan shpenzimet administrative dhe tarifën për ujin e shfrytëzuar, bazuar në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Ndryshimi ose anulimi i lejes

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht, para mbarimit të afatit të përcaktuar, kur:

1. Përfituesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara më sipër;
2. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes bën azhornimet përkatëse lidhur me burimin konform ndryshimit të planeve të burimeve ujore, ndryshim i cili prek edhe burimin ujqor, objekt i kësaj leje;
3. Kushtet e dhënies së lejes kanë ndryshuar;
4. Burimi ujqor është drejt shterimit;
5. Aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë, është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit;
6. Në qoftë se për shkak të forcave madhore ndodhin ndryshime në prurjen, cilësinë, kufijtë e burimit, etj, dhe këto ndryshime sjellin pamundësinë e përdorimit të tij nga zotëruesi i lejes, ky i fundit ka të drejtë t'i drejtohet organit kompetent, që i ka dhënë lejen, për ta anuluar atë;
7. Ka ndryshime të legjislacionit përkatës në fushën e ujërave dhe që prekin drejtpërdrejtë kushtet e kësaj leje.